



AS-Audit Services sh.p.k  
Adresa: Nr. "Kosova Rrye", Nd.35, H.2, Aq.7  
Njësia Administrative Nr.3, 1019, Tiranë  
Mobil: 069 70 99 204  
E-mail: afrim.suli@outlook.com

## **Raporti javor i ndërmjetëm monitorimi, periudha 17-23 Qershor 2019**

### **Për Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve**

Rruga "Ibrahim Rugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri

**Monitorues/Eksperti financiar: Afrim Suli**

**Zgjedhjet: Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, 30 Qershor 2019**

**Partia/subjekti elektoral: Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë**

Edhe përgjatë kesaj jave kemi vazhduar punën për realizimin e shërbimit të kontraktuar, monitorimin e shpenzimeve të fushates zgjedhore të Partisë Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë(ADK).

Ashtu si dhe javet e kaluara, kemi qënë në kontakte të vazhdueshme me drejtuesin e fushatës zgjedhore të partisë, zotin Zef Bushati, për të marrë në kohë informacione për kalendarin e zhvillimit të aktiviteteve dhe shpenzimeve të fushatës.

Sipas deklarimeve të partisë, për periudhën që mbulon raportin, nuk ka patur aktivitete të zhvilluara nga partia dhe shpenzime të destinuar për fushatën zgjedhore.

Por, pavarësisht deklarimeve të partisë, ne kemi kryer monitorime direkte terren, në disa bashki ku partia është paraqitur me lista shumëemërore për keshilltare bashkiake, për të verifikuar dhe vertetuar ekzistencën e zyrave elektorale, aktiviteteve zgjedhore, vendosjen e materialeve propagandistike, kryejnë e shpenzimeve në funksion të tyre etj., konkluzionet e të cilave rezultojnë të jenë si vijon:

### **Rezultatet e monitorimit dhe gjetjet e periudhës**

#### **a) Rajoni dhe/ose bashkia të monitoruara:**

Për periudhën 17-23 Qershor 2019 janë vëzhguar bashkitë si më poshtë vijon:

Nr	Bashkitë e monitoruara ne terren	Evidenca e marrë-gjetjet, 17-23 Qershor 2019		
		Ekzistenca e zyrave	Aktivitetet zgjedhore	Materiale të fushatës të ndaluara
	M.Madhe	Nuk janë gjetur zyra zgjedhore	Nuk ka patur aktivitete	Nuk ka publicitet fushate
	Vau Dejë	Nuk janë gjetur zyra zgjedhore	Nuk ka patur aktivitete	Nuk ka publicitet fushate
	Pukë	Nuk janë gjetur zyra zgjedhore	Nuk ka patur aktivitete	Nuk ka publicitet fushate
	Fushë Arrës	Nuk janë gjetur zyra zgjedhore	Nuk ka patur aktivitete	Nuk ka publicitet fushate

**a) Shkeljet e mundëshme të identifikuara të detyrimeve ligjore të fushatës zgjedhore**

**Zyrat elektorale**

- Në bashkitë e monitoruara ne terren nuk u evidentuan zyra elektroirale që përdoreshin nga ADK.

**Aktivitete zgjedhore**

- Nuk u evidentuan aktivitete të organizuara nga partia ADK.

**Materiale të fushatës të ndaluara**

- Nuk u evidentuan në asnje rast materiale me natyrë publicitare dhe propagandistike dhe kosto të mundëshme me natyrë zgjedhore.

**Emisione televizive dhe spote**

- Po ashtu dhe nga ndjekja e emisioneve radio e televizion nuk kemi konstatuar aktivitete që kanë lidhje me fushatën e kësaj partie.

**Monitorues/Ekspertë financiar**

**Afrim Sull**

**Tiranë, më 23 Qershor 2019**